



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:082962

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05700718

KPPP.nr. 489/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, adresa Instituti B, kati përdhese, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit B.Sh.M., person përgjegjës në barnatoren “B.Sh.M.” me numër të biznesit 811382978 dhe me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 115/2024 të datës 20.02.2024, të lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur Bogaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 17.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.Sh.M., person përgjegjës në barnatoren “B.Sh.M.” me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 115/2024 i datës 20.02.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur Bogaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Farmaceutik, në bazë të dokumentit përbarues - Vendimit Nr. 10/JG-004-22 i datës 15.05.2023 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 115/2024 të datës 20.02.2024 ndaj debitorit B.Sh.M., të cilin e ka detyruar që sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 2,000.00 EUR (dymijë euro), si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se farmacistja në momentin e ardhjes së inspektoratit në vizitë, nuk ka qenë e pranishme pasi që ka qenë në marketin afër barnatores, për të blerë diçka për nevoja personale. Mirëpo edhe pse nuk ka qenë e pranishme në atë moment ajo është e punësuar me kontratë të rregullt dhe orar të plotë të punës, gjë që

dëshmohet edhe nga kontrata e punës dhe raportet ditore. Andaj edhe ka kërkuar që rasti të vendoset nga gjykata dhe jo nga inspektorati dhe përmbaruesit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 10/JG-004-22 të datës 15.05.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 10/JG-004-22 i datës 15.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 14.02.2024.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit

të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 489/24, datë 17.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.